

**AKT THEMELIMI**  
**I SHOQËRISË ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR**

**“SOL 2022” SH.P.K.**

Sot, më date **20.12.2021**, une i nënshkruari:

- **Isidor Bano** lindur me **22/06/1972**, ne Lushnje dhe me rezidence ne Lushnje, shtetas Shqiptar i identifikuar nepermjet leternjoftimit nr.**034749389**, madhor me zotesi te plote juridike per te vepruar....; në përputhje me Ligjin Nr. 9901, datë 14.04.2008, “Për Tregtaret dhe Shoqëritë Tregtare” kam vendosur të themeloje një Shoqëri me Përgjegjësi të Kufizuar të emëruar “**SOL 2022**” **SH.P.K.** (më poshtë referuar si “Shoqëria”), duke nënshkruar këtë Akt Themelimi. Aktiviteti i kësaj Shoqërie do të rregullohet nga Statuti i saj, i cili është pjesë përbërëse e këtij Akti Themelimi dhe i bashkëngjitet si Shtojca 1.

**Neni 1**

Emri i Shoqërisë është: “**SOL 2022**” **SH.P.K.**

**Neni 2**

(1)Selia e shoqërisë ndodhet në adresën: Lushnje, Lagja “Clirimi” objekt me nr.117-G1 dhe nr.117-N1 pasurie dhe zk 8571 .

(2)Adresa e shoqërisë për qëllime komunikimi elektronik është si vijon: *isidorbano@yahoo.it*  
Shoqëria ka te drejte te hape dege apo filiale ne te gjithe territorin e Republikes se Shqiperise.

**Neni 3**

-Kohëzgjatja e shoqërisë do të jetë 10 vjet dhe fillon qe prej dates se regjistrimit te saj ne Regjistrin e Shoqerive Tregtare ne Qendren Kombetare te Biznesit.

**Neni 4**

**Objekti**

Shoqëria do të kryej aktivitetin e mëposhtëm :

a. Tregti artikuj te ndryshem ushqimor, import-export etje.

-Megjitheate shoqëria ka te drejte qe te shtoje dhe te ndryshoje objektin e veprimtarise se saj me vendim te asamblese se ortakeve.





## Neni 5

### Kapitali themeltar

(1) Kapitali themeltar fillestar i shoqërisë është **33 000 000** (tridhjetë e tre milion) **leke i ndare ne 20 000 000** (njetete milion) leke kapital ne vlere qe ortaku i vetem deklarone ne dispozicion te aktivitetit dhe **13 000 000** (trembedhjetë milion) leke kapital ne natyre (vlere e 279 m2 ndertese kati i pare prone e ortakut te vetem dhe garazh i vleresuar me vlere tregu) . Pjesëmarrja e themeluesve në kapitalin e shoqërisë është në përputhje me kontributet e tyre të mëposhtme:

1. Ortaku themelues **Z. Isidor Bano**: Zotërues i 1 (një) kuote me vlerë të përgjithshme prej **33 000 000** (tridhjetë e tre milion) Leke që përbën **100 %** të kapitalit themeltar të shoqërisë.

Kontributi i ortakëve do të jetë në para.

## Neni 6:

### Zmadhimi dhe zvogëlimi i kapitalit

Shtimi ose pakesimi i kapitalit themelor mund te behet vetem pasi Asamblea e ortakeve me shumice e ka dekretuar kete dhe per me teper te gjithe ortaket jane te detyruar qe ta repektojne dhe te kontribuojne ne para ose ne natyre ne baze te vendimit te shumices se asmblese

## Neni 7:

### Transferimi i kapitalit

Kuotat e kapitalit te një shoqërie me përgjegjësi të kufizuar e te drejtat që rrjedhin prej tyre mund te fitohen apo kalohen pëpërmjet:

- a) kontributit në kapitalin e shoqërisë
- b) shitblerjes;(me te drejten e parablerjes nga ana e ortakeve).
- c) trashëgimise;
- d) dhurimit;
- e) cdo menyre tjetër të parashikuar me ligj.

Pjesët e kapitalit themeltar janë ligjerisht të trasferueshme ndërmjet ortakëve,përsa nuk parashikohet ndryshe në statut.

Pjesët e kapitalit themeltare janë ligjerisht të trasferueshme me rrugë trashgimnie.



## Neni 8

### Organi Vendimmarres

Asambleja e Ortakeve është organi i vetem vendimmarrës i shoqërisë. Asambleja e Ortakeve është organi i vetem vendimmarrës i shoqërisë që miraton çdo ndryshim të statutit sipas modaliteteve të përcaktuara në ligj.

Mënyra e thirrjes së mbledhjes së Asamblesë së Përgjithshme, kuorumi, marrja e vendimeve ,përfashtimi nga e drejta e votës dhe te tjera modalitete per funksionimin e organit vendimmarres percaktohen ne statutin e shoqërisë.

## Neni 9

### Administrimi

Administrator i shoqërisë emerohet **Z. Isidor Bano** lindur me 22/06/1972, ne Lushnje dhe me rezidence ne Lushnje, shtetas Shqiptar i identifikuar nepermjet leternjoftimit nr.034749389, madhor me zotesi te plote juridike per te vepruar, i zgjedhur per nje periudhe 5 vjecare me te drejte rizgjedhje.

Kompetencat dhe përgjegjësitë e Administratorit jane te percaktuara qarte ne statutin e shoqërisë.

## Neni 10

### Viti financiar-ekspertët

Viti financiar i shoqërisë fillon me 1 Janar dhe përfundon me 31 Dhjetor. Përfashtimisht, viti i parë financiar fillon nga data e rregjistrimit në Qendrën Kombëtare të Biznesit dhe mbyllet më 31 Dhjetor.

Eksperti ka për detyrë që të kontrollojë të gjithë dokumentacionin kontabel të veprimtarisë ekonomiko tregtare të shoqërisë, atë gjithëvjetor dhe atë në lidhje me kontrollet periodike të ushtruara prej tij për rastet kur ai është ngarkuar dhe ka kryer një gjë të tillë i ngarkuar nga ana e ortakëve.

Në përfundim të kontrollit eksperti kontabël i autorizuar pregatit raportin me shkrim për nxierien e rezultatit të bilancit financiar vjetor si dhe për atë për kontrollet periodike të ushtruara, të cilat është i detyruar që tja paraqesë e ta dorëzojë në kohë ortakëve për ti shqyrtuar e miratuar mbi bazën e të drejtës vendimore që ka.





**Neni 11**

**Prishja-riorganizimi i shoqërisë**

Modalitetet për prishjen dhe riorganizimin e shoqërisë janë të përcaktuara në statutin e shoqërisë në përputhje me dispozitat ligjore të parashikuara në Pjesën IX të Ligjit 9901 datë 14.04.2008 "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare".

**Neni 12**

Akti i Themelimit është hartuar në 4 kopje origjinale.

**ORTAKU I VETEM I SHOQËRISË**

**ISIDOR BANO**

Isidor Bano  
